



Fondacioni i Shqiptarëve Globalë Thirrje për Propozime Gjatë Vitit 2015 13 Tetor 2015

[Shoqata Shqiptaro-Amerikane](#) (MAASBESA) dhe [Organizata e Grave Shqiptaro-Amerikane – Motrat Qiriaz](#) (AAWO) kanë krijuar një partneritet, duke themeluar në muajin Gusht 2015, Fondacionin e Shqiptarëve Globalë ([Global Albanians Foundation \(GAF\)](#)), të mbështetur nga shqiptarët që jetojnë jashtë vendeve të tyre, dhe të tjerë që dëshirojnë të mbështesin organizatat jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi.

Ne kemi bindjen e plotë se sektori jo-fitimprurës në këto vende luan një rol kritik në fuqizimin dhe avancimin e zhvillimit qytetar, ekonomik dhe shoqëror. Në kohën e tanishme, organizatat jo-qeveritare (NGO) në Europën Juglindore po marrin gjithnjë e më pak mbështetje nga komuniteti donator ndërkombëtar, ndërkohë që vendet e këtij rajoni vazhdojnë të zhvillohen. Si rezultat, mbështetja nga shqiptarët që jetojnë jashtë vendit, do të jetë një forcë e madhe, për të përmbushur dhe përballuar nevojat e organizatave jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse që shërbejnë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Angazhimi i GAF-it në mbështetje të NGO-ve shqiptare, do të ndihmojë për të krijuar një financim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, ndaj përjasjeve të reja dhe shumë të dobishme, në mbështetje të iniciativave shoqërore, ekonomike dhe qytetare në këto vende.

Në fazën fillestare, ne do të akordojmë Grante të vogla në shumat USD 1,000 deri 2,000, për organizatat jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi, gjatë muajve të fundit të 2015. Afati për dërgimin e propozimeve është 20 Nëntor, dhe formatin për aplikim mund ta [gjeni tek ky link](#). Plotësimi i aplikimit mund t'ju zgjasë rreth një orë. Nëse jeni të interesuar, ju lutem dërgoni aplikimin e organizatës suaj në gafproposals@maasbesa.org. Ne do t'ju njoftojmë për vendimin e marrë brenda datës 15 Dhjetor 2015.

Nëse kërkon më shumë të dhëna rreth Fondacionit të Shqiptarëve Globalë, ju [lutem lexoni deklaratën për shtyp të datës 11 Gusht 2015](#), bashkë me listën e [Bordit të Drejtorëve dhe Këshillit Drejtues](#), dhe [pasqyrën biografike të sejcilit](#).

Përgëzimet tona, dhe shpresojmë të punojmë së bashku me ju dhe të tjerë si ju, për këtë nismë të rëndësishme, nga e cila do të përfitojnë shqiptarët kudo që jetojnë, dhe veçanërisht shqiptarët me banim në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi.

Sinqerisht,

Dr. Mark Kosmo, Kryetar i GAF-it
Kryetar i MAASBESA

Sinqerisht,

Dr. Anna Kohen, Zëvendës-Kryetare e GAF-it
Presidente e AAWO – Motrat Qiriaz